



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 118/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.12.2020, të parashtruar nga "GRUPI I OE VIKTORY COM DHE MARISA SHPK" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parkingjve në Qytet", me Nr. të Prok: 632-20-7438-5-2-1, nxjerr:

### VENDIM

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për ri-shqyrtim e "GRUPI I OE VIKTORY COM DHE MARISA SHPK" e dates 14.12.2020, lidhur me aktivitetin e "Ndërtimi i Parkingjve në Qytet", me Nr. të Prok: 632-20-7438-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 18.12.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë **18.12.2020**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të ri vlerësojë aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Arsyetim

**GRUPI I OE VIKTORY COM DHE MARISA SHPK** me datë 22.12.2020, ka parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Ndërtimi i Parkingjve në Qytet”**, me Nr. të Prok: **632-20-7438-5-2-1**,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.12.2020, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 se OE i rekomanduar për dhënie nuk ka plotësuar Deklaratën nën betim sic duhet, AK sqaron se Deklarata nën betim është plotësuar sic duhet në të gjitha pikat e saj andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.
2. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 2 se OE i rekomanduar për dhënie ka paraqitur një listë të projekteve dhe makinerisë por nuk dihet se për cilin projekt se nuk ka titull dhe numër të projektit, AK sqaron se OE ka ofruar listat sic ka qenë kërkesa në dosje të tenderit në faqe numër 31 dhe atë ka këto të dhëna si vijon: Titulli i kontratës, Data e nënshkrimit të kontratës, Data e përfundimit të kontratës, Vlera totale e kontratës, Emri i Blerësit, E-maili i Blerësit dhe Numri i telefonit të Blerësit si dhe Lista e pajisjeve ka të dhënat sic është kërkuar në dosje të tenderit dhe atë si vijon: Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve, Sasia e kërkuar (cope), Sasia që ofron ofertuesi, Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexi. I targave, mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj), pra janë plotësuar konform kërkesës së AK në dosje të tenderit andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.
3. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 3 se OE i rekomanduar për dhënie ka paraqitur një bachelor për komunikacion i cili nuk është inxhinier por bachelor, AK sqaron se OE ka ofruar me diplomë të bachelor dhe jo me inxhinier andaj kjo pikë është e bazuar.
4. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 4 se OE i rekomanduar për dhënie i mungojnë licencat e kërkuara, AK sqaron se OE nuk ka dorëzuar këto certifikata andaj kjo pikë është e bazuar.
5. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 5 se OE i rekomanduar për dhënie dhe Grupi i OE JOOS-KRASNIQI & VIZION PROJEKT kanë ofruar marrëveshje me OE “K B ESSE SHPK” dhe se nuk kanë siguruar autorizim për semafora dhe mungon katalogu, AK sqaron se me rastin e sqarimeve të publikuara me datë 07.12.2020 është dhënë sqarim se duhet ofruar dëshmi si certifikata, katalogje etj. dhe sqaron se këta dy OE nuk kanë ofruar këto dëshmi kjo pikë e ankesës është e bazuar.
6. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 6 se Grupit të OE JOOS-KRASNIQI & VIZION PROJEKT i mungon garancioni i punimeve, AK sqaron se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit tek FDT që të dëshmohet një gjë e tillë dhe ka qenë vetëm kërkesë e specifikave teknike andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

7. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 7 se Grupi i OE JOOS-KRASNIQI & VIZION PROJEKT se Deklaratën nën betim se kanë plotësuar sic duhet pasi që mungon titulli dhe numri i projektit, AK sqaron se që të dy deklaratat nën betim të dy anëtarëve të grupit janë plotësuar sic duhet dhe sa i përket asaj që ka thënë OE ankues AK sqaron se konform LPP neni 59 pika 4 (ii) kjo përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

8. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 8 se Grupi i OE JOOS-KRASNIQI & VIZION PROJEKT paraqitur një listë të projekteve dhe makinerisë por nuk dihet se për cilin projekt se nuk ka titull dhe numër të projektit, AK sqaron se OE ka ofruar listat sic ka qenë kërkesa në dosje të tenderit në faqe numër 31 dhe atë ka këto të dhëna si vijon: Titulli i kontratës, Data e nënshkrimit të kontratës, Data e përfundimit të kontratës, Vlera totale e kontratës, Emri i Blerësit, E-maili i Blerësit dhe Numri i telefonit të Blerësit si dhe Lista e pajisjeve ka të dhënat sic është kërkuar në dosje të tenderit dhe atë si vijon: Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve, Sasia e kërkuar (cope), Sasia që ofron ofertuesi, Të dhënat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona reth. I targave, mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj), pra janë plotësuar konform kërkesës së AK në dosje të tenderit andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

9. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 9 se Grupi i OE INTRAST SH.P.K. & SH. Drini Company SH.P.K. nuk ka plotësuar Deklaratën nën betim sic duhet, AK sqaron se Deklarata nën betim është plotësuar sic duhet në të gjitha pikat e saj andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

10. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 10 se Grupi i OE INTRAST SH.P.K. & SH. Drini Company SH.P.K. se janë të paautorizuara për sinjalistike dhe për semafora, AK sqaron se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Kopje: Grupi i OEt Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

